ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **SHSKUK - SHËRBIMI SPITALOR KLINIK UNIVERZITAR I KOSOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	**00220-25-1284-1-1-1**
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për: **"Furnizim me Barna nga LE për SHSKUK -012" Lot 6**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Liri - Med SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga Agim Ramadani nr.80

(Adresa)

Prishtinë **10 000**

(Vendi) *(Kodi postar)*

044-197-571 ***N*/A**

(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Lirim Mustafa

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Tenders.lirimed@gmail.com

(Adresa elektronike)

19.05.2025

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Data e njoftimit për kontratë: 26.02.2025 Hapja e ofertave, e planifikuar:19.05.2025 Kërkesa për rishqyrtim: 13.05.2025 Vendimi për kërkesën për rishqyrtim: 16.05.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** ☐

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 27 i LPP-së
Neni 62 i LPP-së
Neni 17.7 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik
Neni 43 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim
Vendimi i OSHP-së nr.0193/2025 i dt.05.05.2025.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Data e njoftimit për kontratë është bërë me dt.26.02.2025, kurse hapja e ofertave ishte parashikuar të bëhet me dt. 24.03.2025. Ne me dt.14.03.2025, kishim parashtruar kërkesë për rishqyrtim, kundër njoftimit për kontratë, ndërsa kërkesa jonë ishte refuzuar me dt.17.03.2025. Ne pastaj kemi vazhduar me dorëzim të ankesës në OSHP, ku për ankesën tonë është nxjerr ekspertiza e ekspertit shqyrtues me nr.2025/0193 e dt.02.04.2025, përmes të cilës është aprovuar si e bazuar ankesa jonë, ndërsa i njëjti ka propozuar që AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.
Me dt.05.05.2025 është nxjerr vendimi i OSHP-së me nr.2025/0193, ku edhe paneli shqyrtues e ka

aprovuar ankesën tonë si të bazuar dhe është detyruar AK të bëj përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjas afatin e ofertimit.

Pretendimi i vetëm ankimor ka qenë si më poshtë:
Me vendimin e Ministrit të Shëndetësisë nr.89/IV/2024 të dt.05.04.2024, për ndryshim-plotësimin e Listës esenciale të nivelit primar, sekondar dhe terciar të barnave dhe materialit shpenzues e cila mbulohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës, është marr vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e listës esenciale. Me të njëjtin vendim është obliguar Sekretariati i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë ti njoftoj të gjitha institucionet për zbatimin e listës së barnave esenciale dhe materialit shpenzues.

Kur analizohet lista e ndryshuar me vendimin e lartcekur, në fund të listës esenciale shkruan si në vijim:

Preparatet biosimilare porositen vetëm nëse janë në listën e aprovuar nga EMA	
Përdorimi i antibiotikëve bëhet sipas udhëzuesit për përdorimin e antibiotikëve në KPSH (MSH, 2023)	

Shih linkun si në vijim:
https://msh.rks-gov.net/Documents/DownloadDocument?fileName=Vendi43450841.7098.pdf

Përderisa një kërkesë e tillë është specifikuar në listën esenciale, atëherë kemi kërkuar që për produktet Biosimilare, të kërkuara për Lot 6, të specifikohet dhe vendoset kërkesa në dosje të tenderit si në vijim "**Preparatet biosimilare porositen vetëm nëse ato produkte janë në listën e aprovuar nga Agjencia Europiane e Barnave (EMA).**

Siç është e njohur barnat biosimilare ndikojnë drejtpërdrejt në shëndetin e pacientëve, andaj kërkesa jonë që në dosje të tenderit të përcaktohet dhe të vendoset që të porositen vetëm produktet e aprovuara nga EMA krijon siguri shëndetësore dhe njëkohësisht redukton mundësinë e trajtimit të pacientëve me barna dhe produkte të pasigurta dhe njëkohësisht e njëjta kërkesë do të ishte në përputhje të plotë me listën esenciale.

Në mungesë të një kërkese të tillë, atëherë në këtë aktivitet të prokurimit do të mund të ofertojnë kompani të cilat posedojnë produkte biosimilare me standarde të pasigurta dhe më të ulëta në cilësi, të cilat nuk janë në përputhje me rekomandimet ndërkombëtare, duke rrezikuar efikasitetin dhe sigurinë e trajtimit.
Pra, një kërkesë e tillë është e domosdoshme të vendoset në dosje të tenderit për të siguruar që produktet e furnizuara për Lot 6 të jenë në përputhje me standardet më të larta farmaceutike dhe të mbrojnë shëndetin e pacientëve.
Kjo është konfirmuar edhe me vendimin e OSHP-së Nr.2025/00193 i dt.05.05.2025

Pas nxjerrjes së vendimit të OSHP-së, autoriteti kontraktues me dt.07.05.2025, ka publikuar formularin standard për korrigjim të gabimeve, ku e njëjta jo vetëm që nuk e ka respektuar vendimin e OSHP-së nr.2025/0193, për të bërë përmirësimin e dosjes por e njëjta në kundërshtim të plotë me vendimin e lartcekur të OSHP-së, ka bërë korrigjimin e dosjes duke e ka anuluar në tërësi Lot 6, pa ndonjë bazë ligjore.

Tek formulari standard për korrigjim të gabimeve AK-ja ka dhënë arsyetimin si në vijim: Lot-6 produkti enoxaparin 60 mg 0.6 mL 58840 Copë Anulohet në ketë fazë dhe do të vazhdojmë me lotet tjera pas definimit lidhur me kriteret të cilat do të vendosen AK-SHSKUK me AKPPM-në, ky produkt do të iniciohet përsëri.

Ky arsyetim i AK-së është i paqëndrueshëm dhe i njëjti është në kundërshtim të plotë me vendimin e OSHP-së, andaj kemi kërkuar që të bëhet korrigjimi/përmirësimi i dosjes së tenderit dhe njëkohësisht të vazhdohet me procedurat e mëtutjeshme edhe për Lot 6 sikurse për Lotet tjera, konform vendimit të OSHP-së nr.2025/0193. Po ashtu kërkojmë nga OSHP-ja që të detyrojë AK-së të respektojë vendimin e OSHP-së nr.2025/0193.

Ne me dt.16.05.2025 kemi pranuar vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim si të palejueshme, ku AK-ja e ka cekur si në vijim:

Arsyetim: Autoriteti Kontraktues ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit të lartë cekur sipas LPP-së, në përputhje me dispozitat e ligjit ne fuqi dhe kërkesës nga njësia kërkuese për inicimin e procedurës së prokurimit ashtu siç është e përshkruar në LE.

Duke u bazuar në Rregulloren për prokurimin publik tek Neni 60, Paraqitja e kërkesës për rishqyrtim dhe afatet kohore po ashtu dhe Neni 63, Vendimi i Autoritetit Kontraktues prandaj Kërkesa juaj për Rishqyritim është e jashtë afatshme.

Përfundim: Në bazë të arsyeve të lartcekura Autoriteti Kontraktuesi SHSKUK-së e refuzon këtë kërkesë për rishqyrtim si të **Pa-Lejueshme .**

Ju rikujtojmë se subjekt i ankesës me numër 2025/0193 ka qene loti-6, produkti: **enoxaparin 60 mg/0.6 mL** ky lot është larguar nga ky aktivitet pasi te zgjidhet qështja e dokumentacionit te nevojshëm nga Njësisë Kërkuese Barnatorja Qendrore -SHSKUK dhe AKPPM-se, do te iniciohet prape . Për informacionin tuaj vendimi i OSHP-së 2025/0193 ka të bëjë me vetëm për produktin: **enoxaparin 60 mg/0.6 mL** , ndërsa nuk ka pasur ankesë për lotët tjera dhe aktiviteti i tyre ka vazhduar.

Ky arsyetim i AK-së është i pabazuar, pasi që nuk është nxjerr njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit për të filluar afati për kërkesë për rishqyrtim, mirëpo ne kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër korrigjimit të dosjes, me të cilin korrigjim është anuluar proceduar për Lot 6 edhe pse nuk kemi një njoftim për anulim të këtij Loti, pra nuk kemi formularin B58 të publikuar.

Po ashtu është i paqëndrueshëm arsyetimi i AK-së ku i është referuar nenit 60 dhe 63 të rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik, sepse kërkesa për rishqyrtim është parashtruar pesë ditë para afatit të fundit për ofertim, pavarësisht korrigjimit të dosjes së tenderit. Pra në këtë rast nuk kemi pasur zgjatje të afatit për ofertim por afati i fundit për ofertim ka qenë afat i rregullt (19.05.2024), pra afat i cili nuk është zgjatur dhe kërkesa për rishqyrtim është dorëzuar me dt.13.05.2025 (pesë ditë para hapjes së ofertave), prandaj arsyetimi i AK-së nuk ka bazë ligjore.

Nga të gjitha dëshmitë dhe sqarimet që u cekën më lartë vijmë në përfundim se anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit për Lot 6 është bërë në mënyrë kundërligjore dhe në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së.

Po ashtu nuk janë plotësuar asnjëra prej kushteve të përcaktuara në nenin 43.5 dhe 43.7 të Rregulloren nr.001/2022 Për Prokurim Publik.
Anulimi i lot 6 është në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së përkatësisht paragrafët 1, 2, 3 dhe 6. Paragrafi 1 i nenit 7 parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente".
Paragrafi 6 i dispozitës së nenit 7 parasheh qartë : Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit".

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe kundërshtimet tona që u cekën më lartë, rezulton se dosja e tenderit nuk është përpiluar në harmoni me nenin 27 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është pas

parasysh as nenin 17.7 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik ku shkruan qartë që "Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk: Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve".

Duke u bazuar në të gjitha ato që u përmendën më lartë, rezulton se në këtë mënyrë nuk mund të arrihet qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të këtij ligji, e ku shkruan qartë: Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.
Duke u bazuar në faktet që u përmenden me lartë, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që të shqyrtoj ankesën tonë dhe të nxjerr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e **OE Liri - Med SH.P.K.**
NDRYSHOHET/PËRMIRËSOHET dosja e tenderit konform vendimit të OSHP-së nr.2025/0193, të vazhdohet me procedurat e mëtutjeshme për Lot 6 dhe të veprohet konform nenit 53.7 të LPP-së
OBLIGOHET, autoriteti kontraktues ta zbatoj vendimin e OSHP-së Nr. 2025/0193 të dt.05.05.2025.
Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale akoma nuk janë llogaritur sepse jemi në fazën e njoftimit për kontratë dhe fazën para ofertuese.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*